BPrAL - PPoHE
Kolegji AAB
PRISHTINË

KOLEGJI AAB
AAB COLLEGE
Prishtinë
Nr. 1771/17 data: 13.07.2017

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN E STUDIMEVE MASTER

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-037 Për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutit të Kolegjit AAB, Senati në mbledhjen e mbajtur me datën 23.06.2017 miraton këtë:

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN E STUDIMEVE MASTER

I. Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Rregullorja për Organizimin e Studimeve Master (në tekstin e mëtejmë "Rregullorja") mbështetet në Statutin dhe aktet tjera të Kolegjit AAB dhe plotëson dispozitat e tij.

Neni 2

Kjo Rregullore aplikohet në të gjitha njësitë akademike, programet e studimit, departamentet apo drejtimet.

Neni 3

Qëllimi i nxjerrjes së kësaj Rregulloreje është:

a. Të rregullojë organizimin e studimeve master;
b. Të parashohë kushtet për regjistrim në studimet master;
c. Të rregullojë procedurën e temës;
d. Çështje tjera rreth temës;
e. Të përcaktojë rregulla të tjera që kanë të bëjnë me përfundimin e studimeve master dhe çështje tjera më rëndësi.

Neni 4

Studimet e nivelit master mund të organizohen në të gjitha ato njësi akademike apo programe studimi që janë të akredituara apo licencuara nga organet kompetente.

Neni 5

Çështjet organizative rreth organizimit të studimeve të nivelit master janë përgjegjësi e Dekanateve në bashkëpunim me Rektoratin.

II. Regjistrimi i studentëve

Neni 6

Regjistrimi në studimet master bëhet në bazë të konkursit i cili duhet të përmbajë programin e studimit dhe kushtet e regjistrimit.

Neni 7

Studimet pasdiplomike të nivelit master kanë të drejtë t'i regjistrojnë të gjithë ata kandidatë të cilët i kanë përfunduar studimet themelore bachelor dhe që kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS) respektivisht 240 kredi (ECTS).

Neni 8

Në një program të studimeve master mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet themelore bachelor nga drejtimi (profili) i njëjtë si dhe të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kushtet plotësuese për regjistrim të studimeve në profilin përkatës, siç është rregulluar në dispozitën në vijim.

Neni 9

a. Studentët që kanë përfunduar studimet themelore nga fusha e njëjtë e studimit sipas sistemit 4 vjeçar (240 ECTS), për ta fituar gradën Master, duhet të akumulojnë së paku edhe 60 ECTS nga programi i profilit të njëjtë sipas një vendimi të Dekanatit.
b. Studentët që kanë mbaruar studimet në programe te ndryshme nga profili për të cilin konkurrojnë mund të regjistrohen në studime master mirëpo paraprakisht obligohen t'i japin provimet themelore të atij programi, në studimet Bachelor. Kjo kategori e provimeve njihet si "Provimet Diferenciale".
c. Studentët që kanë përfunduar studimet themelore dhe kanë arritur 180 ECTS respektivisht 240 ECTS në një program studimi i cili përputhet më shumë se 50% me programin themelor të studimeve, obligohen të ndjekin programin vijues të studimeve Master dhe këta studentë lirohen nga dhënia e provimeve plotësuese (diferenciale).
d. Për secilin rast sipas paragrafit III te këtij neni dhe për çdo rast tjetër të veçantë, vendimet i merr Këshilli i Studimeve Master.

Neni 10

a. Numri i provimeve diferenciale të një programi bachelor 3 (tre) vjeçar që akumulon 180 ECTS është 3 (tre).
b. Numri i provimeve diferenciale të një programi bachelor 4 (katër) vjeçar që akumulon 240 ECTS është 5 (pesë).
c. Provimet diferenciale janë të standardizuara për programin e studimit dhe nuk lejohet ndryshimi i tyre. Secili rast, në bazë të specifikave, procedohet me vendim të veçantë të dekanatit.
d. Studenti vetëm pasi t'i japë të gjitha provimet diferenciale, fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimeve nga studimet master.

Neni 11

Provimet diferenciale shënohen në raporte të veçanta të provimeve.

III. Kohëzgjatja e studimeve

Neni 12

Studimet master zgjasin 2 apo 4 semestra, varësisht prej programit të studimit dhe në përfundimin e tyre studenti fiton 60 ECTS përkatësisht 120 ECTS.

IV. Format e mësimit

Neni 13

Mësimi në studimet master zhvillohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve, konsultimeve, punëve laboratorike, praktikave profesionale, detyrave të kursit, provimeve të kursit, provimeve të formimit, temave të diplomave dhe formave tjera të parapara me Rregulloren për Studime.

Neni 14

a. Të drejtën e ligjërimit në studimet pasdiplomike-master e ka personeli akademik me thirrje shkencore, akademike (Profesor i rregullt, Profesor i asocuar, Profesor asistent dhe Doktor shkence). Përjashtimisht mund të ligjërojnë edhe mësimdhënësit me gradën e magjistrit, të cilët llogariten si kuadër deficitar (nga fusha e arteve).
b. Të drejtën e mentorimit e kanë vetëm profesorët të cilët i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1 i këtij Neni dhe një profesor mund të ketë në proces të mentorimit maksimum 10 tema njëkohësisht.

V. Afatet e provimeve

Neni 15

Afatet e provimeve, orari i provimeve dhe çështje të tjera rreth afatit të provimeve janë të rregulluara me Rregulloren për Studime.

Neni 16

Provimet përveç mënyrës së rregullt të mbajtjes së tyre, mund të mbahen edhe nga një komision nëse studenti është ankuar apo është e përcaktuar me programin e studimeve.

VI. Vlerësimi

Neni 17

Suksesi në provime vlerësohet me këto nota:

- 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)
- 8 (shumë mirë)
- 7 (mirë)
- 6 (mjaftueshëm) dhe
- 5 (pamjaftueshëm)

Neni 18

Dekanati kërkon listën preliminare të temave të cilat mund t'i zgjedhin studentët. Lista do të publikohet nga ana e dekanatit.

VII. Këshilli i Studimeve Master

Neni 19

a. Këshilli i Studimeve Master është organ i themeluar nga Këshilli Shkencor Mësimor i Fakultetit, i cili përbëhet nga pesë (5) anëtarë nga radhët e profesorëve të cilët i plotësojnë kushtet.
b. Dekani në mbledhjen e parë të Këshillit Mësimor Shkencor i propozon anëtarët e Këshillit të Studimeve Master, duke pasur për bazë kriterin e gjithëpërfshirjes së disiplinave të programit.
c. Dekani i fakultetit, sipas detyrës zyrtare, është anëtarë dhe udhëheqës i Këshillit të Studimeve Master.
d. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Studimeve Master është njëvjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
e. Mandati i Anëtarëve të Këshillit të Studimeve Master mund të përfundojë edhe para kohe në rast të mospërmbushjes së detyrave, me propozim të Dekanit dhe miratim të Këshillit Mësimor.
f. Këshilli i Studimeve Master vendimet i merr me shumicë të thjeshtë të votave.

Neni 20

a. Gjatë semestrit të fundit të ligjëratave apo pas përfundimit të provimeve, studenti ka të drejtë që Këshillit të Studimeve Master të Fakultetit t'i drejtohet me kërkesë për lejimin e "projekt temës së masterit". Po ashtu, ai mund të propozojë mentorin.
b. Studenti duhet të plotësojë kërkesën për lejimin e punimit të temës dhe projekt propozimin e temës sipas formatit të institucionit.
c. Vetëm pas përfundimit të provimeve të parapara në Programin e studimeve, miratohet Projekti i temës së propozuar.
d. Këshilli i Studimeve Master pas shqyrtimit të kërkesës për lejimin e temës së diplomës, vendos për "lejimin" ose "refuzimin" e punimit të temës së masterit.

e. Në rastet kur studenti i ka të përfunduara të gjitha provimet dhe ka bërë kërkesën për miratimin e temës së Masterit, Këshilli i Studimeve Master duhet t'i japë përgjigje në afat prej 15 ditësh.

Neni 21

Temat e masterit mund të merren vetëm nga fusha e studimit në programin përkatës të studimit apo edhe nga çështjet me karakter interdisiplinar.

Neni 22

Me lejimin e temës së masterit, Këshilli i Studimeve Master i fakultetit emëron komisionin prej tre anëtarësh, prej tyre cakton kryetarin e komisionit dhe mentorin i cili do të punojë me kandidatin. Këshilli i Studimeve Master mund të marrë vendim për plotësimin e komisionit në rast se njëri nga anëtarët tërhiqet nga komisioni, po ashtu mund të marrë vendim për ndryshimin e komisionit nëse njëri nga anëtarët nuk i kryen detyrat e parapara.

Neni 23

Obligimet e Mentorit janë:

a. Pas miratimit të projektit, mentori nënshkruan pëlqimin për mentorim dhe ndershmëri akademike
b. Mban konsulta të rregullta me kandidatin
c. Obligohet që të ketë takime konsultative minimum dy (2) herë nga dy orë brenda kampusit te AAB-së.
d. Plotëson dhe nënshkruan formularin e takimeve të mbajtura me kandidatin duke specifikuar punët e kryera dhe detyrat e caktuara për fazën vijuese.
e. Jep pëlqimin për të përcjellë temën dy anëtarëve tjerë të Komisionit.
f. Shkruan referatin e vlerësimit

Neni 24

Obligimet e Anëtarit janë:

a. Lexojnë dhe, në rast se kanë, ofrojnë komente për punimin e dorëzuar
b. Në afat prej 15 ditësh pas pranimit të punimit, obligohet që të dërgojë komentet te kandidati dhe mentori i punimit ose të konfirmojë se punimi është në rregull.
c. Kjo procedurë mund të përsëritet maksimum tri (3) herë dhe nëse edhe pas herës së tretë studenti nuk i përfillë rekomandimet e anëtarit të Komisionit, atëherë ky i fundit mund ta rezervojë të drejtën për ndarje të mendimit dhe për këtë duhet të shkruajë raport të veçantë.

Neni 25

Punimi i masterit duhet të jetë punë origjinale e kandidatit dhe duhet t'i përmbushë kriteret e standardeve profesionale, duhet të jetë i shkruar qartë në pajtim me rregullat e hartimit të punimeve shkencore, me një terminologji të përpunuar dhe me redakturë e teknikë të përshtatshme.
Për nga forma, punimi i tezës së diplomës për master duhet të duket si vijon:

- Fonti i shkronjave duhet të jetë 12pt,
- Tipi duhet të jetë "Times New Roman",
- Rrallori duhet të jetë 1.5.
- Në ballinë duhet të jetë
    - Stema
    - Emri i Kolegjit;
    - Emri i Fakultetit/Niveli dhe emërtimi i Programit;
    - Titulli i temës;
    - Emri i mentorit në të djathtë;
    - Emri i kandidatit në të majtë;
    - Në fund, vendi dhe viti i punimit.
- Pastaj një faqe duhet të jetë e zbrazët,
- Pastaj një faqe me të dhënat identike që janë në ballinë,
- Pastaj është përmbajtja,
- Hyrja,
- Shtjellimi i temave,
- Konkluzionet/Përfundimet dhe
- Literatura.

Neni 26

Për zbatimin e Nenit të mësipërm, do të nxirret udhëzues i veçantë i cili do të përcaktoj rregullat e shkrimit të tezës dhe ndershmërisë akademike.

Neni 27

Studenti mund të zgjedhë temën nga lista e temave të masterit të propozuara nga profesori. Po ashtu mund të përcaktohet edhe për ndonjë temë tjetër, me kusht që ajo temë mos të jetë shtjelluar gjatë tri viteve të kaluara.

Neni 28

Tema e masterit nuk duhet të ketë më pak se 50 faqe pa shtojcë, sipas standardit të paraparë.

Neni 29

a. Punimi i masterit nuk mund të mbrohet më herët se 2 (dy) muaj nga dita e aprovimit të "projekt temës së masterit" dhe jo më vonë se 1 (një) vit nga data e marrjes së vendimit.

b. Në rast se kandidati nuk arrin të mbrojë temëm brenda afatit prej një viti, me kerkesë të veçantë dhe arsyetim mund të shtyhet afati edhe për 6 (gjashtë) muaj.
c. Pas kësaj periudhe kandidati obligohet t'i fillojë procedurat e miratimit të temës nga fillimi.

Neni 30

Pas konfirmimit të anëtarëve se tema i plotëson kriteret për mbrojtje, mentori në afat prej 7 ditësh obligohet që të shkruajë referatin për kandidatin dhe temën e masterit, ta nënshkruajnë të tre dhe ta dorëzojnë në Këshillin për Studime Master.

Neni 31

Nëse njëri nga anëtarët e komisionit ka mendim ndryshe, ai mund të hartojë referat të veçantë dhe t'ia bashkëngjisë referatit kryesor.

Neni 32

a. Këshilli i Studimeve Master pas pranimit të referatit nga komisioni, merr vendim për "miratim" apo "refuzim".
b. Pas miratimit të referatit, kandidati në bashkëpunim me Komisionin dhe administratën cakton datën e mbrojtjes, por jo më herët se 7 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë nga data e miratimit të referatit.
c. Në rastin kur refuzohet referati, Këshilli për Studime Master mund të caktojë një afat prej 15 ditësh për plotësim dhe përmirësim të referatit.

Neni 33

Kandidati punimin e masterit duhet ta dorëzojë në 6 kopje:

- Një kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për bibliotekën;
- Një kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për Arkivin;
- Një kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për dosjen e studentit;
- Tri kopje në format origjinal (të përgatitur në libër A4) për secilin anëtar të Komisionit;
- Një CD në formatin PDF për bibliotekën elektronike të AAB-së.

Neni 34

Mbrojtja e punimit të diplomës bëhet publikisht para Komisionit, mësimdhënësve, studentëve, kolegëve, familjarëve, miqve dhe të interesuarve tjerë.

Neni 35

Kandidati, gjatë mbrojtjes publike e prezanton punimin në formën që zgjedh vetë (sllajdeve, fletëve etj), varësisht prej llojit të punimit.

Neni 36

Kohëzgjatja e prezantimit është prej 15 deri 30 minuta. Kryetari i Komisionit pas përfundimit të prezantimit ua jep mundësinë anëtarëve të Komisionit të bëjnë pyetje lidhur me punimin dhe vetë prezantimin. Pyetje mund të parashtrojë edhe vetë Kryetari dhe audienca.

Neni 37

Pas përfundimit të prezantimit dhe pyetje/përgjigjeve, Komisioni tërhiqet për 5 deri 15 minuta nga salla për të përfunduar vlerësimin e punimit të diplomës dhe prezantimin e kandidatit. Secili anëtarë në mënyrë të pavarur dhe të barabartë propozon vlerësimin, ndërsa Kryetari bën kalkulimin dhe vlerësimin përfundimtar.

Neni 38

a. Vlerësimi i kandidatit mund të jetë: "me sukses të dalluar", "me sukses", "nuk kalon".
b. Nëse kandidati, për arsye subjektive, dështon që të mbrojë publikisht punimin, i mundësohet edhe një herë që të bëjë mbrojtjen e temës në afat prej 30 ditësh.

Neni 39

Pas rikthimit, Kryetari i Komisionit shpall vendimin për përfundimin e temës, vlerësimin e Komisionit dhe titullin e arritur nga kandidati, një kopje e vendimit i dorëzohet edhe kandidatit.

Neni 40

Administrata, Arkivi, referentët përgjegjës, janë të obliguar të mbajnë evidencën e rregullt (kopjen e punimit të diplomës, kopjen e vendimit të Komisionit dhe dokumenteve tjera) për të gjithë diplomantët.

Neni 41

Përgatitjen e dokumentacionit juridik për Komisionin e bën Referenti i Fakultetit përkatës në bashkëpunim me Sekretarin.

Neni 42

Dekanati mund të marrë vendime për plotësimin e procedurës apo rregullimin e çështjeve tjera rreth organizimit të studimeve master.

VIII. Plagjiatura

Neni 43

Plagjiatura është term që definohet në shumicën e fjalorëve dhe referencave bibliotekarë si paraqitje nga ana e një personi të ideve, punës kreative të një personi tjetër si të tij pa e bërë të njohur atë (Pears & Shields, 2005).
Sipas përvojave shkencore dhe akademike plagjiatura përveç veprimeve tjera përfshin më së shpeshti edhe veprimet në vijim:

a. Parafrazimin e informacionit nga një burim, pa e bërë të ditur origjinën e burimit dhe pa e referencuar atë;
b. Kopjimin dhe vënien e informacionit, grafikës apo ndonjë tjetër lloj të medias, pa e bërë të ditur burimin;
c. Përdorimin e punimeve të dikujt tjetër apo blerjen e punimeve apo hulumtimeve të cilat vetë nuk i kanë bërë;
d. Mosvënien e thonjëzave kur citohet pjesë e një informacioni të cilin e kanë marrë plotësisht.

Për të evituar plagjiaturën studentët duhet të konsultohen me profesorët për çfarëdo paqartësie para se ta dorëzojnë punimin. Studentët po ashtu udhëzohen që të ndjekin udhëzimet zyrtare të Universitetit në lidhje me referencimin dhe udhëzimet e profesorëve për punimet e tyre.
Plagjiatura dënohet, nëse ajo konstatohet. Studentit për të cilin konstatohet që ka bërë plagjiaturë, i refuzohet punimi.

IX. Mashtrimi

Neni 44

Mashtrim konsiderohet nëse studenti kopjon gjatë testit apo provimit. Mashtrimi mund të bëhet në disa mënyra:

a. Kopjimi nga letra (nëse ajo nuk është e lejuar me rregullat e provimit);
b. Marrja e rezultateve me gojë apo me shkrim nga kolegu;
c. Si dhe forma tjera të cilat nuk paraqesin punën origjinale të studentit;

Nëse profesori konstaton se studenti ka kopjuar, ia anulon provimin duke e shënuar sjelljen e tij edhe në raportin e provimeve.

Neni 45

Rektori nëpërmjet Zyrës së Prorektorit për Shkencë mund të mbikëqyrë zbatimin e kësaj Rregulloreje, për: respektimin e procedurave, vlerësimin e ndonjë punimi të masterit nga një Komision shkencor ad hoc.

X. Dispozitat Kalimtare

Neni 46

Kjo Rregullore plotëson rregulloret tjera të Kolegjit AAB.

Neni 47

Në rast se dispozitat e kësaj Rregulloreje bien ndesh me dispozitat e Statutit, përparësi kanë dispozitat e Statutit.

Neni 48

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e mëparshme për Organizimin e Studimeve Pasdiplomike dhe çdo dispozitë tjetër që ka rregulluar këtë fushë.

Neni 49

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit të saj nga Senati dhe nënshkrimit nga Rektori.

Kryesuesi i Senatit

Dr. Lulzim Tafa, Rektor

Prishtinë 2017

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVO · REPUBLIC OF KOSOVA · KOLEGJI AAB · PRISHTINE 2001 · AAB COLLEGE